



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 tetor 2018
Nr. ref.: RK 1283/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI26/18

Parashtrues

“Jugokoka”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
- Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës,
GSK-KPA-A-71/2015, të 27 Korrikut 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga ndërmarrja “Jugokoka” me seli në Beograd, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), e përfaqësuar me autorizim nga Brankica Ljamić-Ivanović.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit GSK-KPA-A-71/2015 të Gjykatës Supreme të Kosovës - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), të 27 korrikut 2017, të cilën parashtruesja e kishte pranuar më 24 tetor 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, me anë të të cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrotja e Pronës], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 [Parimet e Përgjithshme] dhe 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi në seancë administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 22 shkurt 2018, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 26 shkurt 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërzhaliu –Krasniqi (anëtarë).
8. Më 8 mars 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit.
9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

11. Më 10 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues të përbërë nga: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërxxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani (anëtare).
12. Më 26 shtator 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se më 14 dhjetor 2006, parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP), duke kërkuar ri-posedimin e një lokali afarist me sipërfaqe 20,69 m², i cili gjendet në adresën: “Dardania”, Lamella 1.3, lokali 4/II në Prishtinë.
14. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesja e kërkesës kishte informuar AKP-në se “JUGOKOKA ishte privatizuar ashtu që Milorad Ljamić është pronar i saj në masën 60% , ndërsa DOO BRANY, në masën 40%”.
15. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, kundër Entit për Urbanizëm, Projektim dhe Inxhinjeri në Prishtinë dhe Qeverisë së Kosovës, për pengim të posedimit dhe kompenzim të dëmit (lidhur me të njëjtën pronë).
16. Më 22 shkurt 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin P-1663/04, u shpall me jo-kompetencë lëndore për zgjidhjen e kontestit dhe lëndën e parashtrueses e kishte referuar në AKP.
17. Në ndërkohë, pas vdekjes së Milorad Ljamić (më 22 janar 2013), procedura ligjore për parashtruesen e kërkesës është vazhduar nga e bija e tij, Brankica Ljamić-Ivanović si trashëgimtare ligjore e tij.
18. Më 30 prill 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës i AKP-së (në tekstin e mëtejme: KKPK), me Vendimin grupor KPCC/D/C/240/2014, refuzoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës. KKPK fillimisht arsyetoi si në vijim: *“Parashtruesi i kërkesës pronësore ka të drejtë për urdhrin e komisionit mbi kthimin e pronës nëse parashtruesi i kërkesës dëshmon: (a) Pronësinë mbi pronën e paluajtshme private [...] apo (b) Të drejtën e shfrytëzimit të asaj prone të paluajtshme private [...] ku parashtruesi i kërkesës apo bartësi i të drejtës së pronës, siç e dikton rasti, momentalisht nuk është në gjendje të gëzojë të drejtën e vet të pronës, si dhe kur në kërkesën pronësore përfshihen rrethana që janë drejtpërdrejtë të lidhura, apo janë rezultat i konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë [...].*
19. Në fund, KKPK e refuzoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës me arsyetimin se *“[...]në bazë të dokumenteve të parashtruara nga ana e parashtruesit të kërkesës apo në bazë të dokumenteve të grumbulluara nga ana e sekretarisë ex officio apo në bazë të deklaratës së parashtruesit të kërkesës [...] parashtruesit nuk kanë dëshmuar se kërkesat e tyre përmbajnë rrethana që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë apo që kanë rezultuar si pasojë e konfliktit në vitet 1998-1999. Sipas kësaj, të gjitha kërkesat, bien jashtë kompetencës së komisionit dhe për këtë arsye ato refuzohen.”*

20. Më 8 tetor 2014, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë kundër vendimit të KKPK-së pranë Kolegjit të Apelit. Parashtruesja e kërkesës në ankesën e saj kishte theksuar se Milorad Ljamić (babai, gjegjësisht trashëgimlënësi i Brankica Ljamić-Ivanović) ishte pronar i pronës në fjalë në bazë të kontratës mbi bashkimin e mjeteve për ndërtim të hapësirave afariste dhe se këtë pronë e ka pasur në posedim ligjor deri në qershor të vitit 1999. Më tutje, parashtruesja e kërkesës në ankesën e saj, pretendonte se *"[...] babai im u bë pronar dhe posedues i pronës lëndore qysh nga viti 1992, nëpërmes shumicës pronësore në ndërmarrjen Jugokoka."*
21. Më tej, parashtruesja e kërkesës në ankesën e saj kishte theksuar: *"[...]babai im ka pasur të drejtën pronësore ndaj pronës lëndore dhe se unë si trashëgimtare e tij ligjore i plotësoj të gjitha kushtet me të cilin kjo e drejtë, e cila është humbur për shkak të rrethanave të cilat janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me, apo janë nxitur nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, të më kthehet."*
22. Më 27 korrik 2017, Kolegji i Apelit nxori Aktgjykimin GSK-KPA-A-71/2015, me anë të të cilit vendosi të: *"Refuzohet si e pabazuar ankesa e Jugokoka [...] dhe të 'Vërtetohet vendimi [...] KPCC/D/C/240/2014, i datës 30 Prill 2014 [...]"*
23. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, ndër të tjera, thuhet:

"Sipas nenit 3.1 të Ligjit 03/L-079 [Ligji Nr. 03/L-079 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK -ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale] paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër nga KKPK-ja për ri-posedimin e pronës, nëse paraqitësi i kërkesës "e dëshmon" të drejtën e tij pronësore apo të drejtën për shfrytëzimin e pronës private, përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, dhe gjithashtu e dëshmon se ai /ajo nuk është në gjendje të ushtroj të drejtën në fjalë për shkak të rrethanave që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 apo për shkak të rrethanave që rezultojnë nga ky konflikt[...]. Pala ankuese është dashur të dorëzonte prova në mbështetje të kërkesës së saj për të dëshmuar të drejtën e pronësisë [...]. Prova e vetme që i referohet palës ankuese si pronare është kontrata e pavërtetuar në gjykatë e cila si e tillë nuk konsiston të drejtën pronësore të pretenduar. Ankesa e palës ankuese ri-sjell pretendimet e njëjta [...] ajo nuk kishte dorëzuar asnjë provë të re."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar i është shkelur e drejta e tij e paraparë me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] e Kushtetutës.
25. Fillimisht, parashtruesja e kërkesës pretendon se KKPK ka konstatuar gabimisht se *"parashtruesit e kërkesës nuk ka vërtetuar se kërkesa(t) e tyre përmbajnë rrethana që drejtpërdrejtë lidhen apo janë rezultat i konfliktit të viteve 1998-1999 [...]"*. Për më tepër, parashtruesja thekson se *"[...]Asnjëherë nuk kemi dhënë diku deklaratë se kërkesa jonë nuk përmban rrethanat që drejtpërdrejtë lidhen apo janë*

rezultat i konfliktit të viteve 1998-1999. As që kam dorëzuar ndonjë dokument ndonjëherë të cilët flasin për një gjë të tillë.”

26. Më tutje, parashtruesja e kërkesës pohon se Kolegji i Apelit “[...]gabimisht e interpreton arsyetimin e Vendimit të Komisionit të Agjencisë Kosovare të Pronës nr. KPCC/D/C/240/2014 datë 30.04.2014. Ajo që Gjykata Supreme e Kosovës, Kolegji i Apelit e pohon, askund nuk ekziston në vendimin e përmendur”.
27. Përkitazi me shpalljen me jo-kompetencë të gjykatave të rregullta, parashtruesja e kërkesës thekson: “Është fakt se as Gjykata Komunale në Prishtinë gjatë procedurës së rregullt e as Komisioni i Agjencisë Kosovare të Pronës e as Gjykata Supreme e Kosovës gjatë procedurës së veçantë të rregulluar me Rregulloren 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale dhe Ligjin nr. 03/L-079, nuk kanë dashur të shqyrtojnë kërkesën time pronësore por e kanë shpallur veten pa kompetencë.”
28. Lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 46, parashtruesja pohon se “Gjykata Komunale në Prishtinë se paku më ka dërguar në procedurën tjetër ndërsa tani, pas përfundimit të procedurës tjetër, edhe më tej nuk kam mundësi që për të drejtat e mia pronësore të merret vendim publik, i paanshëm, i drejtë, brenda afatit të arsyeshëm nga ndonjë gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj.”
29. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon: “[...]të më kompensohet dëmi në vlerën e pronës për të cilën më është pamundësuar mbrojtja e të drejtave pronësore në procedurën e udhëhequr nga ana e një gjykate të pavarur, të paanshme e themeluar me ligj.”

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”
32. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: “Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”
33. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe

lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, par.14).

34. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... ”

35. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesja është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
36. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, duke përfshirë kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Kështu, rregulli 39 (2), i Rregullores së punës përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

37. Fillimisht, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sepse, sipas saj, gjykatat e rregullta, duke konstatuar gabimisht gjendjen faktike e kanë shpallur veten jo-kompetente për të vendosur në çështjen e saj. Si rrjedhojë, ajo nuk ka mundësi që për të drejtën e vet pronësore të merret vendim i drejtë nga një gjykatë e pavarur e themeluar me ligj. Më tej, parashtruesja pretendon se Kolegji i Apelit ka interpretuar gabimisht vendimin e KKPK-së lidhur me rastin e saj, dhe se ajo nuk e ka cekur askund që rasti i saj nuk ndërlidhet me rrethanat që kanë ndodhur në kohën e konfliktit.
38. Duke iu referuar pretendimeve të parashtrueses së kërkesës lidhur me kompetencën e KKPK-së, Gjykata së pari rikujton se me vendimin grupor KPCC/D/C/240/2014, KKPK-ja e refuzoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës, sepse ajo nuk kishte

vërtetuar se kishte humbur posedimin, përkatësisht të drejtat e pronësore, si pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

39. Për më tepër, Gjykata nga vendimi grupor i KKPK-së vëren se në paragrafin 3 të këtij vendimi, KKPK kishte theksuar se parashtuesit kanë të drejtë për urdhrin e Komisionit për Kthimin e Pronës nëse ata dëshmojnë pronësinë. KKPK në paragrafin 35 të Vendimit gjithashtu kishte arsyetuar se KKPK është kompetente në rastet kur konstaton se parashtuesi aktualisht nuk është në gjendje të gëzojë të drejtën e tij të pronës për shkak të rrethanave të konfliktit që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
40. Gjykata po ashtu vëren se vendimi grupor i lartcekur i KKPK-së thekson se *“kërkesat që janë refuzuar për shkak se nuk bien në kompetencën e Komisionit apo për shkak të arsyeve procedurale dhe jo për shkak se nuk kanë bazë, mund të zgjidhen në gjykata lokale [...] Në këso kërkesash vendimi i Komisionit nuk përmban res judicata.”*
41. Gjykata vë në pah se Aktgjykimi GSK-KPA-A-71/2015 i Kolegjit të Apelit sqaroi se parashtuesja ka të drejtë në ri-posedimin e pronës nëse ajo e dëshmon se gëzon të drejtën në pronë dhe se këtë të drejtë nuk mund ta ushtrojë për shkak të konfliktit që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
42. Gjykata, gjithashtu, rikujton se Kolegji i Apelit, mbështetur në shkresat e lëndës, kishte arsyetuar se parashtuesja e kërkesës nuk kishte dëshmuar të drejtën e saj pronësore dhe nuk kishte dëshmuar se ajo nuk mundet ta ushtrojë të drejtën e saj pronësore, për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë me konfliktin që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
43. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se Kolegji i Apelit kishte marrë parasysh pretendimet e parashtueses së kërkesës, duke sqaruar se kontrata që ajo kishte sjellë si provë nuk paraqet bazë për të drejtë pronësore, sepse ishte e pavërtetuar në gjykatë. Për më tepër, parashtuesja nuk e kishte vërtetuar që nuk mund ta ushtrojë të drejtën pronësore si pasojë e konfliktit që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
44. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave apo aplikimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Në të vërtetë, është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - GJEDNJ, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28).
45. Gjykata konsideron se parashtuesja e kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtueses të kërkesës me rezultatin e procedurave nga gjykatat e rregullta nuk mundet vetvetiu të paraqesë pretendim të argumentueshëm për shkelje të së drejtës kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis* rasti i GJEDNJ, *Mezotur*

- *Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005 paragrafi 21).

46. Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në rastin e saj, në ndonjë mënyrë, ishin të padrejta apo arbitrare dhe, si pasojë, me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Vendimi i 30 qershorit 2009).
47. Përkitazi me pretendimet e parashtrueses së kërkesës lidhur me mbrojtjen e pronës, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata i referohet nenit 53 të Kushtetutës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], sipas të cilit Gjykata Kushtetuese është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.
48. Në këtë drejtim, Gjykata vë në pah se neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës (Shih, *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së, *Van der Mussele kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 23 nëntorit 1983, paragrafi 48 dhe rastin e GJEDNJ-së, *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, Aktgjykimi i 9 tetorit 2003, paragrafi 121).
49. Parashtruesja e kërkesës mund të pretendojë shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ vetëm për atë që vendimet e kontestuar kanë të bëjnë me “pronën” e saj. Brenda kuptimit të kësaj dispozite, “pronë” mund të konsiderohet “pasuria ekzistuese”, duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të të cilave parashtruesi mund të ketë “pritshmëri legjitime” që do të fitojë ndonjë të drejtë pronësore. Por shpresa në njohje të të drejtave pronësore nuk mund të konsiderohet me automatizëm si “pronë”, brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ. Sikundër që nuk mund të konsiderohet as një kërkesë që pushon të jetë e vlefshme si rezultat i mospërmbushjes së kriterëve ligjore (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Prince Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafët 82 - 83, dhe rastin e GJEDNJ-së *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, Vendim për pranueshmërinë i 10 korrikut 2002, paragrafi 69 si dhe shih *mutatis mutandis* rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI44/16, *Biljana Topko*, Aktvendim për Papranueshmëri i 31 marsit 2017, paragrafi 41).
50. Gjykata rithekson se në rastin e parashtrueses së kërkesës, Kolegji i Apelit kishte konstatuar se kontrata që ajo kishte sjellë si provë nuk paraqet bazë për të drejtën pronësore sepse nuk ishte e vërtetuar në gjykatë.
51. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesja nuk e ka mbështetur pretendimin për shkelje të të drejtave pronësore, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.
52. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka paraqitur fakte dhe argumente të mjaftueshme që dëshmojnë se procedurat pranë gjykatave të rregullta kanë shkaktuar, në ndonjë mënyrë, shkelje të të drejtave të saj të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtës për mbrojtjen e pronës.


53. Prandaj, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza Kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 26 shtator 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues
Bekim Sejdiu




Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese
Arta Rama-Hajrizi